



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/87
Datë: 09.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, dhe duke u bazuar në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit të Lartë 2005 – 2015, si dhe në kuadër të përkushtimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përfshirje më të madhe në arsimin e lartë, me synimin për të ofruar një arsim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 09 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Themelohet Universiteti i Prizrenit si Institucion Publik i Arsimit të Lartë, i cili do të ofrojë grada universitare dhe diploma të Arsimit të Lartë.
2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të emërojnë një këshill drejtues i cili do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme që Universiteti i Prizrenit të regjistrojë studentët e parë në vitin akademik 2010/2011.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë